



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.107 dt.28.09.2001

MBI

**MIRATIMIN E PROJEKTIT PER RESTAURIMIN, REHABILITIMIN DHE
LYERJEN E DISA FASADAVE TE PALLATEVE NE RR. E KAVAJES**

Në mbështetje të nenit 32 gërma “dh” të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.22 dt.13.02.2001 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2001”, ndryshuar me Vendimin Nr.43 dt.27.04.2001, relacioneve të paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Miratimin e projektit “Projekti i restaurimit, rehabilitimit dhe lysterjeve të disa fasadave të pallateve në Rr. E Kavajës në shumën prej 7.502.438 lekësh në favor të Ndërmarrjes Komunale të Banesave, në cilësinë e ndërmarrjes së specializuar” sipas listës dhe preventivit bashkëngjitur
2. Fondi i mësipërm prej 7.502.438 lekësh të përballohet nga zëri “Ndërtim i një kompleksi sportivë në bashkëpunim me donatorë dhe njësinë Nr.11”
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Ndërmarrja Komunale Banesa
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

